



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2026

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **B.O.E: “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a.** me NIPT: **J62904264O** me adresë: Fshati Balëz Poshtë, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqëzimi i fshatit Kusarth (në kryqëzimin e rrugës së fabrikës së çimentos rrugën e fshatit Balëz Sipër), Balëz Poshtë, Elbasan, **(me operatorë mbështetës: 1. “Rafin Company” sh.p.k** me nipt: **L52125110A**, me adresë: Rruga “Haxhi Kika”, Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538 hyrja 1, apartamenti 4, Tiranë dhe **2. “DELIA IMPEX” sh.p.k** me nipt: **K57123001R**, me adresë: Rruga 7 Shaljante, nr.29 (afër bare restorant Ylli), Shkodër & **“INERTI” sh.p.k** me NIPT: **J66926804L** me adresë: Lagjja Sporti”, Gramsh.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat:

1. “Rafin Company” sh.p.k me nipt: **L52125110A**, me adrese: Rruga “Haxhi Kika”, Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538 hyrja 1, apartamenti 4, Tiranë dhe **2. “DELIA IMPEX” sh.p.k** me nipt: **K57123001R**, me adrese: Rruga 7 Shaljante, nr.29, Shkodër janë O.E mbështetës të O.E **“RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a.**

Tipi i Kontratës: Punë

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-94825-07-29-2026

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Ndërtimi i rrugës së re nga Rotonda e varrezave deri në intersektimin me rrugën "Nos Josifi", lagja "Emin Matraxhiu" me fond limit 54.084.238 (pesëdhjetë e katërmilion e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) lekë pa t.v.sh.,** vene ne dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026, 2027 dhe 2028, dhe me afat 6 muaj për kryerjen e punimeve.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 09.09.2026

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Buletini Nr. 57 datë 14 Shtator 2026*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. B.O.E "BAJRAMI N." sh.p.k me nipt: K027272020 (me operatorë mbështetës: **"COLOMBO" shpk** me nipt: **J82916489E** dhe adrese: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier) & **"ERAL CONSTRUCTION COMPANY" me nipt: K82230002K**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **41.719.719,46** (dyzet e njëmilion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë presje dyzet e gjashtë) lekë (pa tvsh).

2. B.O.E : "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" sh.a. me NIPT: **J629042640** me adresë: Fshati Balëz Poshtë, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqëzimi i fshatit Kusarth (në kryqëzimin e rrugës së fabrikës së çimentos rrugën e fshatit Balëz Sipër), Balëz Poshtë, Elbasan, (me operatorë mbështetës: **1. "Rafin Company" sh.p.k** me nipt: **L52125110A**, me adresë: Rruga "Haxhi Kika", Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538 hyrja 1, apartamenti 4, Tiranë dhe **2. "DELIA IMPEX" sh.p.k** me nipt: **K57123001R**, me adrese: Rruga 7 Shaljante, nr.29 (afër bare restorant Ylli), Shkodër & **"INERTI" sh.p.k** me NIPT: **J66926804L** me adresë: Lagjja "Sporti", Gramsh

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **50.363.270,88** (pesëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë presje tetëdhjetë e tetë) lekë (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. B.O.E "BAJRAMI N." sh.p.k me nipt: K027272020 (me operatorë mbështetës: "COLOMBO" shpk me nipt: J82916489E dhe adresë: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier) & **"ERAL CONSTRUCTION COMPANY" me nipt: K82230002K**

Subjekti "BAJRAMI N." sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 60 % të punimeve sipas kontrates se bashkepunimit.

1. Në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim keni deklaruar se drejtues teknik i punimeve në objekt do të jetë arkitekti z. D. K.

Ne piken 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, percaktohet se: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën dhe listpagesat e shoqërise, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë në inxhinieri ndertimi

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkepunimit.)

Duke qenë se keni marrë përsipër 60% të punimeve vlera e plotë e punimeve të marra përsipër nga subjekti juaj është mbi 30.000.000 leke me tvsh.

Në VKM nr. 448, datë 31.07.2025 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDRËTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT", neni 8, pika 2, përcaktohet se: Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Sa mesiper, nuk permbushni kriterin e percaktuar ne piken 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

2. Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të percaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.***

Sa më sipër, duke qene se subjekti juaj sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje nder te tjera edhe punimet per shtresat e rrugeve (Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri etj), atehere ne kuptim te parashikimeve ligjore te sipercituara dhe në përmbushje te kerkesave profesionale dhe teknike per kualifikim te parashikuara ne piken 2.3.4 te kapacitetit teknik, ju duhet te kishit deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit apo te kishit paraqitur dokumentacion minimalisht per:

- Inxhinier Ndërtimi, profili transport (nuk keni deklaruar asnje)

Sa më sipër, nuk e përmbushni kërkesën e sipërcituar.

Subjekti "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" sh.p.k. ka marrë përsipër që të kryejë 40 % të punimeve sipas kontrates se bashkepunimit.

1. Në pikat 2 dhe 3 të nenit 88 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. *Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Sa më sipër, duke qene se subjekti juaj sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te realizoje punimet: F.V Percjelles PV-500 Ø 10 mm²; F.V Percjelles PPV Ø 2x1.5 mm²; F.V. kablo kontrolli Cu pa armuar, ne mure e konstruksione, 4x4 mm²; F.V kabllo 4x16mm²; F.V Tubo korogato per ambjetin Jashte d63; F.V Ndricues sipas specifikimeve dhe FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10 (100 %); te shtresave si: Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese stabilizant t=10cm, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri; Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri dhe Shtrese binderi me zall lavatrice, 4cm, me makineri, atehere ne kuptim te parashikimeve ligjore te sipercituara dhe në përmbushje te kerkesave profesionale dhe teknike per kualifikim te parashikuara ne piken 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.10 te kapacitetit teknik, ju duhet te kishit deklaruar ne shtojcen 8 të vetëdeklarimit apo te kishit paraqitur dokumentacion minimalisht per:

Staf kryesor teknik (drejtues teknik)

- 1 (nje)Inxhinier Elektrik

Punonjes te kualifikuar:

- 1 (nje) manovrator automakinist (nuk keni deklaruar asnje) -Perdorimi i mjeteve si autobetoniereve, autovinc, autopompebetoni, autobitumatrice
- 1 (nje) manovrator buldozerist (nuk keni deklaruar asnje) Perdorimi i mjeteve si grejder, rrul vibrues, shtruese asfalto-betoni

Mjete/pajisje

- 1 (nje) rrul asfalti hekur–hekur me kapacitet 6 - 8 ton (nuk keni deklaruar asnje)
- 1 (nje) rrul asfalti hekur–hekur me kapacitet 10 - 12 ton (nuk keni deklaruar asnje)

Sa me siper nuk e permbushni kerkesat e sipercituara.

Oferta juaj s’kualifikohet per arsyet e mesiperme.

Ne nenin 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” te LPP percaktohet:

1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **B.O.E: "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" sh.a.** me NIPT: **J629042640** me adresë: Fshati Balëz Poshtë, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqëzimi i fshatit Kusarth (në kryqëzimin e rrugës së fabrikës së çimentos rrugën e fshatit Balëz Sipër), Balëz Poshtë, Elbasan, (**me operatorë mbështetës: 1. "Rafin Company" sh.p.k** me nipt: **L52125110A**, me adresë: Rruga "Haxhi Kika", Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538 hyrja 1, apartamenti 4, Tiranë dhe **2. "DELIA IMPEX" sh.p.k** me nipt: **K57123001R**, me adrese: Rruga 7 Shaljante, nr.29 (afër bare restorant Ylli), Shkodër & **"INERTI" sh.p.k** me NIPT: **J66926804L** me adresë: Lagjja "Sporti", Gramsh, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **50.363.270,88** (pesëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë presje tetëdhjetë e tetë) **lekë** (pa tvsh) se është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Prokurimeve Publike, rruga "Qemal Stafa", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet siguri i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO **X**

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Klaudia Krasnika